



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

**Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore**  
**Me datë 20.9.2022**

<b>Vendimet për DISKUTIM PUBLIK</b>					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Elina Krasniqi	Mës. Matematikë	Përceptimet dhe përvojat e nxënësve të klasës së nëntë në lidhje me mësimin e matematikës në distancë	Kryetar/e	Fahri Marevci
				Mentor/e	Valbona Berisha
				Anetar/e	Jehona Ferizi Miftari
2	Lumni Sefa	Mës. Biologji	Konceptimet e nxënësve të klasave të IX për mbeturinat dhe ndotjen nga mbeturinat komunale	Kryetar/e	Ruzhdi Kuqi
				Mentor/e	Zeqir Veselaj
				Anetar/e	Vlora Sylaj
3	Rinor Zejnullahu	Mës. Gjeografi	Vështirësitë arsimore që ndikojnë në mësimnxënien tek nxënësi në lëndën e edukatës qytetare	Kryetar/e	Ardita Devolli
				Mentor/e	Veli Kryeziu
				Anetar/e	Nusret Pllana
4	Dilek Brina Opoja	Mës. Fizikë	Mësimdhënia dhe të nxëniet e ligjit të Arkimit nëpërmjet eksperimenteve dhe detyrave numerike në shkollën e mesme të lartë	Kryetar/e	Arlinda Damoni
				Mentor/e	Zeqir Shaqiri
				Anetar/e	Fahri Marevci
5	Shqiponjë Halili	Mës. GJLSH	Ndërtimi sintaksor i fjalive në esetë e nxënësve të klasës së nëntë	Kryetar/e	Naser Pajaziti
				Mentor/e	Begzad Baliu
				Anetar/e	Arlinda Beka
6	Mimoza Dajja	Mës. GJLSH	Teknikat e të nxëniet të foljes në shkollën e tretë dhe të katër të kurrikulës	Kryetar/e	Naser Pajaziti
				Mentor/e	Begzad Baliu
				Anetar/e	Minevere Rashiti

**Kandidati/ja: 1. Elina Krasniqi**

**Tema: Përceptimet dhe përvojat e nxënësve të klasës së nëntë në lidhje me mësimin e matematikës në distancë**

### **ABSTRAKT**

Ky hulumtim fokusohet në analizën e përceptimeve të nxënësve të klasës së nëntë në lidhje me mësimin e matematikës në distancë gjatë pandemisë Covid-19. Qëllimet primare të hulumtimit janë (i) ndërtimi i një pasqyre të përceptimeve të nxënësve në fjalë, dhe (ii) shqyrtimi i dallimeve në përceptime në relacion me karakteristikat demografike të nxënësve (gjinia, shkolla, mjedisi urban-rural, shkalla e arsimimit të prindërve, gjendja ekonomike familjare), ku rolin qendror e ka variabli i mjedisit. Metoda e këtij hulumtimi është metoda e përzier.

Instrumentet për mbledhjen e të dhënave janë një pyetësor i strukturuar dhe dhjetë intervista individuale të gjysmëstrukturuara. Pyetësori është administruar i pari, ndërsa intervistat janë zhvilluar pas analizës së rezultateve të pyetësorit. Populacioni në fokus janë nxënësit e klasave të nënta të komunës së Gjilanit. Hulumtimi ka dy mostra. Njëra ka shërbyer për mbledhjen e të dhënave kuantitative dhe është probabilitare, ndërsa tjetra ka shërbyer për mbledhjen e të dhënave kualitative dhe është joprobabilitare. Për analizën e të dhënave kuantitative është përdorur statistika deskriptive (masat e tendencës qendrore, masat e variabilitetit) dhe statistika inferenciale (ANOVA). Ndërsa, për të dhënat kualitative është përdorur analiza tematike. Të gjeturat e këtij hulumtimi tregojnë se nxënësit kishin përvoja dhe deklarime mikse. Përvojat pozitive rezultuan të jenë fleksibiliteti në kohë, qëndrimi në shtëpi dhe avancimi në përdorimin e TIK-ut dhe platformave online. Ndërsa, përvojat negative ishin problemet me rrjet, ndërprerja e rrymës, vështirësia për t'i shkruar simbolet, vështirësia për t'i kuptuar detyrat, problemet shëndetësore, mungesa e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit fizik me mësimdhënësin dhe me shokët e shoqet e klasës, mungesa e mjeteve mësimore, si dhe pakënaqësitë e nxënësve për vlerësim jo të drejtë. Pavarësisht këtyre përvojave negative, përvoja e fituar gjatë vitit 2020 është një eksperiencë e mirë për të përmirësuar cilësinë e mësimin në distancë. Megjithatë, ata nuk dëshirojnë që kjo përvojë të përsëritet dhe sipas tyre mësimi në distancë konsiderohet të jetë më i papërshtatshëm për lëndën e matematikës sesa për lëndët e tjera. Mjedisi rural apo urban nuk rezultoi të jetë faktorë dallues për përceptimet e nxënësve në lidhje me mësimin e matematikës në distancë.

**FJALËT KYÇE:** Klasa e nëntë, Matematikë, Mësim në distancë, Mjedis urban, Mjedis rural

## **Kandidati/ja: 2. Lumni Sefa**

Tema: Konceptimet e nxënësve të klasave të IX për mbeturinat dhe ndotjen nga mbeturinat komunale

### **ABSTRAKTI**

Jemi dëshmitarë të degradimit çdo ditë e më shumë të mjedisit rreth nesh, jetojmë në një vend në të cilin nuk mund të thuhet se respektohen mjaftueshëm ligjet për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja. Si pasojë e gjithë kësaj shihet nevoja që të ndërmerren aksione gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e mjedisit nga degradimi me anë të mbeturinave, gjithashtu gjelbërimi i sa më shumë hapësirave do të kishte funksion balancues në këtë aspekt.

Nëpërmjet këtij hulumtimi, e përveç matjes së njohjes së koncepteve të mbeturinave nga ana e nxënësve, është synuar të bëhet edhe sensibilizimi i mëtejshëm i tyre si qytetarë të përgjegjshëm, të gatshëm në parandalimin e dukurive negative ndaj mjedisit. Në këtë hulumtim janë studiuar njohuritë e nxënësve të klasëve të IX-ta, lidhur me ndotjen nga mbeturinat dhe klasifikimin e tyre, përfshirë ndikimin mjedisor, social dhe shëndetësor të tyre në realitetin që ata e jetojnë.

Pyetja kryesore e hulumtimit është se sa kanë njohuri nxënësit e klasëve të IX-ta mbi konceptet e mbeturinave, ndotjen e mjedisit nga mbeturinat, pasojat në shëndet dhe mjedis me fokus klasifikimin dhe riciklimin e tyre? Hipoteza e këtij hulumtimi është se nxënësit e klasëve të IX-ta kanë njohuri të larta mbi konceptet e ndotjes, klasifikimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Hulumtimi është i tipit kuantitativ dhe është realizuar në SH.F.M.U. "Iliria" në Prishtinë. Teknika e hulumtimit është anketimi ndërsa instrumenti i hulumtimit është pyetësori që përmban një numër pyetjesh lidhur me mbeturinat, klasifikimin dhe ndotjen që vjen prej tyre. Pyetësori është hartuar në shumicën e pyetjeve në pajtueshmëri me Shkallën e Likertit. Rezultatet e hulumtimit kanë treguar shkallën se sa i njohin nxënësit konceptet problemet mjedisore që lidhen me mbeturinat, ndotjen e mjedisit nga mbeturinat dhe pasojat në shëndet e mjedis.

**Fjalët kyqe:** koncept, mjedis, mbeturina, nxënës, riciklim.

**Kandidati/ja: 3. Rinor Zejnullahu**

**Tema: Vështirësitë arsimore që ndikojnë në mësimnxënie tek nxënësi në lëndën e edukatës qytetare**

#### **ABSTRAKTI**

Në këtë punim të masterit u shqyrtuan vështirësitë arsimore që ndikojnë në mësimnxënie tek nxënësi në lëndën e edukatës qytetare. Mësimdhënësit janë ata që ndikojnë në krijimin e klimës së përshtatshme të të nxënësit për nxënësit, si në aspektin e njohurive ashtu edhe në aspektin psikologjik, social dhe emocional. Mësuesit duhet të kenë një përcaktim të qartë të barrierave në të nxënë përpara se të identifikojnë nxënësit në klasë.

Metodologjia e përdorur gjatë këtij hulumtimi ishte rasti studimor me mësimdhënësit e lëndës së edukatës qytetare në komunën e Gjilanit të cilët janë përgjigjur pyetjeve të intervistës të ngritura mbi qëllimet dhe pyetjet hulumtuese të studimit.

Hulumtimi ka dy pyetje kryesore dhe ka qasje kualitative. Qëllimi është që të zbulojmë cilat janë barrierat që ndikojnë në mësimnxënie te nxënësit, si ndihen ata dhe kush janë shkaktarët e atyre pengesave. Në intervistën me pyetje të gjysmë strukturuara morën pjesë 38 mësimdhënës të lëndës së edukatës qytetare.

Nga ky hulumtim u nxorën përfundime se nxënësit kanë vështirësi në kuptimin e teksteve shkollore, koordinimin në aktivitetet mësimore. Gjithashtu u vunë në pah edhe synimet e parapara për lëndën e edukatës qytetare si synime të cilat nuk lidhen shumë me jetën e përditshme dhe përgatitjen e nxënësit si qytetar i përgjegjshëm në shkollë, familje dhe komunitetin ku jeton dhe do të veprojë në të ardhmen.

**Fjalët kyçe: nxënës, vështirësi, mësimnxënie, edukatë qytetare**

#### **Kandidati/ja: 4. Dilek Brina Opoja**

Tema: Mësimdhënia dhe të nxënit e ligjit të Arkimit nëpërmjet eksperimenteve dhe detyrave numerike në shkollën e mesme të lartë

#### **ABSTRAKTI**

Qëllimi i këtij punimi është shqyrtimi i mësimdhënies dhe të nxënit e ligjit të Arkimit nëpërmjet eksperimenteve dhe detyrave numerike në shkollën e mesme të lartë. Struktura e këtij punimi përbëhet nga gjithsej katër kapituj (Ligji i Arkimit; Ushtrimet praktike dhe eksperimentet; Metodologjia dhe Analiza e të Dhënave).

Poashtu, punimi do të mundohet të sjell informacione të shumta në vijim rreth përdorimit në praktikë të ligjit të Arkimit (përdorimin e detyrave llogaritëse/eksperimentale) dhe rëndësinë e tij. Më saktë, punimi do të jetë një tregues përse ligji i Arkimit duhet të shërbej për zgjerimin e të kuptuarit, pasurimin e formimit logjik, nxitjen e kureshtjes të nxënësve dhe ngritjen shkencore të nxënësve, prandaj përdorimi i saktë dhe mirë zbatueshmëria e këtij ligji duhet të jenë fokus kyç i mësimdhënësve të lëndës së fizikës.

Për të realizuar punimin do të shfrytëzohet metodologjia e kombinuar (sasiore dhe cilësore). Pjesëmarrës në punim pritet të jenë gjithsej 200 respondentë, nga të cilët 190 prej tyre janë nxënës të paraleleve të njëmbëdhjeta, të cilët vijojnë mësimet e tyre në Shkollën e Mesme të Lartë, Gjinnazin “Gjon Buzuku” në Prizren dhe në Shkollën e Mesme të Lartë, Gjinnazin “Jeta e Re” në Suharekë si dhe 10 mësimdhënës të lëndës së fizikës në po të njëjtat shkolla.

Në funksion të mbledhjes së informacioneve, si instrument për hulumtim cilësor do të hartohen dy pyetësorë për kategoritë e lartëpërmendura veç e veç, pyetësori për nxënësit pjesëmarrës dhe pyetësori për mësimdhënësit e lëndës së fizikës. Rezultatet e pritura janë potencimi i rolit të ligjit të Arkimit, zbatimi i detyrave llogaritëse dhe eksperimentale në kuadër të tij, si dhe identifikimi i përdorimit dhe vlerësimit momental të këtij ligji, nga nxënësit dhe mësimdhënësit e kësaj shkolle.

**Fjalët kyçe:** detyrat, fizika, ligji i Arkimit, mësimdhënia, mësimnxënia

**Kandidati/ja: 5. Shqiponjë Halili**

**Tema:** Ndërtimi sintaksor i fjalive në esetë e nxënësve të klasës së nëntë

**ABSTRAKTI**

Hulumtimi ka për objekt studimi esetë e nxënësve të klasës së nëntë, të shkollës fillore të mesme të ultë “Petro Nini Luarasi”, në Llapçevë, komuna e Malishevës. Këtyre punimeve në ese u jemi qasur në aspektin gramatikor duke vënë në dukje, më tepër, parregullsitë në aspektin sintaksor që hasen në këto shkrime. Hulumtimi vë theksin dhe ka për qëllim të paraqesë faktin se sa kanë arritur nxënësit e klasës së nëntë të përvetësojnë dhe të shkruajnë drejt një fjali. Pjesë e hulumtimit janë 30 nxënësit e klasës së nëntë, të cilëve u është kërkuar të shkruajnë një ese, me temë të lirë. Esetë nuk janë më të gjata se 200 fjalë dhe nuk janë të korigjuara a të notuara nga mësimmhënësi i lëndës. Përzgjedhja e nxënësve të këtij niveli është e qëllimshme, pasi supozohet që ata tashmë dijnë të shkruajnë drejt një fjali apo të ndërtojnë një tekst.

Punimi ndahet në dy pjesë. Fillimisht është shqyrtuar literatura, e cila pastaj është ndarë në nënkapituj për të argumentuar secilin problem që është hasur në esetë e nxënësve. Ndërsa, në pjesën tjetër studimi i analizon këto probleme në aspektin didaktik thellohet në analizimin e detajizuar të shkrimeve. Për më shumë, në secilën ese, janë trajtuar problemet, si: përdorimi i panevojshëm i përemrave, mospërshtatja e formave kohore të fjalive të një paragrafi, përseritja e shpeshtë elidhëzave etj.

Në bazë të literaturës së marrë në shqyrtim dhe problemeve të trajtuara, qëllimi i hulumtimit është të japë një pasqyrë të problemeve sintaksore dhe të tregojë, në mënyrë të përgjithshme, nivelin e përgatitjes së këtyre nxënësve në përfundim të nivelit të mesëm të ulët të mësimnxënies.

**Fjalë kyçe:** sintaksë, fjalia, ndërtimi i fjalisë, eseja.

## **Kandidati/ja: 6. Mimoza Daija**

**Tema:** Teknikat e të nxëniet të foljes në shkallën e tretë dhe të katër të kurrikulës

### **ABSTRAKTI**

Objekti i studimit të kësaj teme do të jenë librat shkollorë të klasës së gjashtë, shtatë dhe tetë, më konkretisht temat mësimore në të cilat shtjellohet folja. Si pjesë e ligjëratis, ajo shënon një veprim a gjendje dhe ndryshon sipas vetës, mënyrës, kohës e numrit; zgjedhohet, për dallim nga pjesët e tjera të ndryshueshme, të cilat lakohen; është bërthamë e fjalisë, ndaj duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë trajtimit të kësaj teme gjatë procesit të mësimdhënies dhe njëkohësisht, paraqet një interes të veçantë në të nxëniet e saj nga nxënësit, sepse ka shumë kohë, të cilat ngatërrohen, pastaj mënyrat, zgjedhimet dhe problematika të ndryshme të kësaj natyre, të cilat paraqesin vështirësi në strukturën e fjalisë.

Ilustrimi dhe demonstrimi i kësaj pjese të ligjëratis, kërkon aftësi dhe strategji të ndryshme për ta transmetuar informacionin saktë dhe mjaftueshëm te nxënësi. Njoftimi, lidhur me foljen, fillon që nga klasa e dytë dhe vazhdon kështu duke u zgjeruar në nivelet tjera. Duke pasur parasysh ndikimin dhe rëndësinë që ka folja te nxënësi, nëpërmjet këtij punimi të diplomës, ne synojmë që t'i kushtojmë vëmendje të veçantë trajtimit të saj (foljes), qoftë nga ana e mësimdhënësit (shkollës), qoftë nga trajtimet që i bëhen në tekste shkollore. Pra, qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë identifikimi dhe shtjellimi i çështjeve të foljes te librat e klasës së gjashtë, shtatë dhe tetë.

Pikësynimi ynë, do të jetë edhe përputhja e këtyre teksteve shkollore me nivelin (shkallën) e nxënësve si dhe identifikimi i faktorëve në mosinformimin e duhur rreth foljes, te nxënësit e klasës së gjashtë. Do t'i qasemi temës së foljes dhe çështjeve që kanë të bëjnë me të përmes metodës kualitative (cilësore), krahasuese, analizuese dhe empirike. Hulumtimi do të bëhet në shkolla publike dhe private të qytetit të Gjakovës, nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave që do t'i plotësojnë nxënësit dhe mësimdhënësit.

Përmes këtij punimi do të përpiqemi të shohim përshtatshmërinë e këtyre teksteve shkollore me shkallën (nivelin) e nxënësve, si janë trajtuar temat mësimore që kanë të bëjnë me foljen, strategjitë dhe taktikat (metodat, teknikat) që përdorin mësimdhënësit për ta bërë sa më produktive mësimdhënien dhe të nxëniet e saj e shumë problematika të tjera që kanë të bëjnë me temën.

**Fjalët çelës (kyçe):** folje, nxënës, mësimdhënës, tekst shkollor, kurrikulë, mësimnxënie.

